

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7871
E mërkurë, 28 gusht 2024
Çmimi 0.50 €

Përrurohen investimet
rreth 800 mijë euro
në Klinikën Emergjente
të QKUK-së | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇFARË DUHET TË DINË QYTETARËT E BALLKANIT PERËNDIMOR PËR RREGULLAT E REJA TË HYRJES NË BE? | FAQE 4-5



"Mirëdita! Pasaportat, ju lutem!
Duhet t'ju marrim edhe gjurmë
të së paku katër gishtërinjve.
Edhe fotografi. Faleminderit
dhe ju uroj qëndrim të

këndshëm!".
Kështu do të duhej të dukej nga
10 nëntori i këtij viti hyrja në
Bashkimin Evropian dhe në
Zvicër, Norvegji, Islandë e

Lihtenshtajn - vende anëtare të
zonës së lëvizjes së lirë
Schengen për qytetarët e rreth
60 vendeve, përfshirë edhe ata
të Ballkanit Perëndimor

**OPOZITA: 4 VJET NË
QEVERISJE, PAGAT
RRITEN ME 6.8 EURO.
THAÇI 10 VJET MË PARË
I KISHTE DYFISHUAR | F. 3**



**QEVERIA PO PËRGATIT LIGJIN
PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE,
KURTI PARALAJMËRON KOSTO
SHTESË PËR QYTETARËT | F. 3**



AKTUALE



**STARMER THOTË SE SITUATA NË
BRITANI DO TË PËRKEQËSOHET
PARA SE TË PËRMIRËSOHET | F. 2**

**HARADINAJ PREMTON QË
PENSIONET DO TË JENË 450 EURO | F. 8**

**PSE SHKALLA E PUNËSIMIT
TË GRAVE NË KOSOVË ËSHTË
AQ E ULËT? | F. 7**

EKONOMI



**NDRYSHOHEN SHKALLËT E TATIMIT
PËR TË ARDHURAT PERSONALE | F. 8**

**HAPET THIRRJA PËR IZOLIMIN E
SHTËPIVE | F. 8**

SPORT



**ADEMI DHE BERISHA DISKUTOJNË
PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS
SË MESME TË FUTBOLLIT | F. 10**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Starmer thotë se situata në Britani do të përkeqësohet para se të përmirësohet

LONDËR, 27 GUSHT - Kryeministri i Britanisë, Keir Starmer, ka thënë të martën se do të duhet kohë e gjatë për të rindërtuar Britaninë dhe për t'ia hequr kalbëzimin, që ai ka thënë se ka ndodhur gjatë qeverisjes paraprake të konservatorëve. Ai ka paralajmëruar që "gjërat do të përkeqësohen, para se të përmirësohen". Starmer, i cili ka fituar zgjedhjet në korrik të këtij viti, është zotuar për të rindërtuar fabrikën e shoqërisë britanike, duke thënë se trazirat e fundit me thirrje kundër migrantëve, kanë reflektuar ndasitë që janë ndërtuar përgjatë 14 vjetëve të Partisë Konservatore në pushtet. Ai e ka mbajtur fjalimin në oborrin e Qeverisë ku ish-

kryeministri britanik, Boris Johnson, ka mbajtur disa festa gjatë periudhës së izolimeve kundër koronavirusit. Sipas Starmerit, veprime të tilla kanë thyer besimin në mes të publikut dhe politikanëve. "Nuk e kemi trashëguar vetëm një vrimë të zezë ekonomike, por edhe një vrimë të zezë shoqërore, dhe për këtë arsye duhet të veprojmë dhe t'i bëjmë gjërat ndryshe. Kjo nënkupton që të jemi të sinqertë me njerëzit për zgjedhjet që bëjmë dhe sa të vështira do të jenë ato", ka thënë ai. "Sinqerisht, gjërat do të përkeqësohen para se të përmirësohen". Duke iu adresuar një audience me mësues, infermierë, pronarë biznesesh të vogla, Starmer ka thënë se ndryshimi nuk do të



ndodhë brenda natës.

Megjithatë, ai ka thënë se Qeveria është e vendosur për t'i

zgjdhur problemet duke nisur nga mbingarkesa në burgje, në problemet me banim, dhe pritjet

e gjata për të marrë shërbime nëpër spitale.

Starmer, ish-udhëheqës i Prokurorisë Publike, është detyruar t'i anulojë pushimet këtë muaj, për t'u përballur me trazirat e së djathtës ekstreme, që kanë shënjestruar myslimanët dhe migrantët.


Trazirat kanë nisur pasi për vrasjen e tri vajzave të vogla në veri të Anglisë është fajësuar rrejtshëm një migrant mysliman, përmes disa postimeve të bëra nëpër rrjete sociale.

Starmer ka thënë se dështimi i Qeverisë së konservatorëve për t'i luftuar problemet, dhe fokusi në populizëm, i kanë zgjeruar çarjet në shoqëri, të cilat, sipas tij, do të marrin kohë për t'u shëruar.

Prokuroria kërkon rikthimin e çështjes ndaj ish-presidentit Trump për dokumentet e klasifikuara

WASHINGTON, 27 GUSHT - Prokurori i posaçëm Jack Smith i ka kërkuar një gjykatë federale të apelit të rikthejë çështjen penale që akuzon ish-presidentin Donald Trump për mbajtjen e dokumenteve të klasifikuara, pasi një gjykatë më e ulët e rrëzoi këtë padë në korrik.

Në kërkesën e paraqitur në gjykatë, prokurori Smith dhe ekipi i tij i kërkojnë Gjykatës së Apelit të Shteteve të Bashkuara me seli në Atlanta, që ka juridiksionin për Qarkun e 11-të, të anulojë vendimin e 15 korrikut të dhënë nga gjyqtarja Aileen Cannon, ku ajo arriti në përfundimin se prokurori Smith ishte emëruar në mënyrë të paligjshme dhe se nuk kishte autoritetin ligjor për ngritjen e



padisë. "Kongresi i ka dhënë Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu si drejtuesve të shumë departamenteve të ekzekutivit, autoritet të gjerë për të strukturuar agjencinë që ai

drejton për të ushtruar përgjegjësitë e vendosura mbi të me ligj", shkruhet në kërkesën e prokurorisë, për të shtuar tutje: "Pikëpamja e kundërt e gjykatës së rrethit bie ndesh me një kurs

ndryshe të pandërprerë vendimesh, përfshirë nga Gjykata e Lartë, se Prokurori i Përgjithshëm e ka një autoritet të tillë dhe është në kundërshtim me praktikën e gjera dhe të hershme të emërimeve në Departamentin e Drejtësisë dhe në të gjithë qeverinë".

Departamenti i Drejtësisë ishte shprehur më parë se kishte në plan ta apelonte vendimin e gjykatës.

Në kërkesën e së hënës, zyra e prokurorit Smith i kërkoj gjithashtu gjykatës së apelit të caktojë një datë për paraqitjen e argumenteve verbale.

Gjykatësja Cannon, e emëruar në këtë detyrë nga ish-Presidenti Trump, ishte shprehur se vendimi i prokurorit të përgjithshëm

Merrick Garland për të emëruar prokurorin e posaçëm Smith në vitin 2022 shkelte Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara. Ajo gjithashtu vendosi se buxheti i zyrës së tij, që financohet nga një fond i pacaktuar, ishte i paligjshëm.

Avokatët e ish-presidentit Trump patën kundërshtuar më parë autoritetin ligjor për emërimin e prokurorit Smith, duke argumentuar se zyra e prokurorit Smith nuk ishte krijuar nga Kongresi dhe ai nuk ishte konfirmuar nga Senati si prokuror i posaçëm. Ekipi elektoral i ish-presidentit Trump tha se gjykata duhet ta refuzojë kërkesën e prokurorit Smith dhe se duhet të pushohen çështjet e tjera me të cilat përballlet ish-presidenti.

Macron: Arrestimi i shefit të Telegramit nuk ishte vendim politik

PARIS, 27 GUSHT - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se arrestimi i Pavel Durov, themeluesit dhe udhëheqësit të aplikacionit të mesazheve Telegram, nuk ishte politik. "Arrestimi i presidentit të Telegramit në tokën franceze u krye si pjesë e një hetimi gjyqësor", shkroi Macron në X. "Tani kjo çështje është në duart e gjykatësve", shtoi ai.

Durov u ndalua në aeroportin Bourget, në periferi të Parisit, më 24 gusht, dhe ende po merret në pyetje.

Telegrami publikoi një deklaratë ku tha se Durovi "nuk ka asgjë për të

fshehur", duke shtuar se kjo platformë "po pret për zgjidhjen e shpejt të kësaj shtate".

Mediat franceze kanë raportuar se OFMIN, një zyrë franceze që merret me parandalimin e dhunës ndaj të miturve, kishte lëshuar një fletarrestim për Durovin për shkelje të dyshuara, përfshirë mashtrim, kontrabandë me drogë, bullizëm në hapësirën kibernetike, krim të organizuar dhe promovim të terrorizmit. "Në qendër të kësaj çështjeje është mungesa e moderimit [të përmbajtjes] dhe bashkëpunimi i platformës, veçmas për luftimin kundër

pedofilisë", shkroi në një postim në LinkedIn kreu i OFMIN, Jean-Michel Bernigaud.

Telegrami, me bazë në Dubai, ka më shumë se 900 milionë përdorues në mbarë botën. Gjatë një interviste në prill, Durov u zotua se Telegrami synon të jetë "një platformë neutrale" dhe jo "lojtar në gjeopolitikë".

Kritikët në Ukrainë, megjithatë thanë se kjo platformë shpërndan dezinformata dhe lehtëson veprimtari ilegale. Disa e kanë akuzuar Telegramin se ka lidhje me shtetin rus dhe e ndihmon në luftën kundër Ukrainës.



Qeveria po përgatit Ligjin për Sigurimet Shëndetësore, Kurti paralajmëron kosto shtesë për qytetarët

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ka bërë me dije të martën se janë duke e përgatitur Ligjin për Sigurimet Shëndetësore.

Ai ka thënë se sigurimet shëndetësore janë zotim i qeverisë së tij, derisa ka shtuar se qytetarët do të kenë kosto shtesë. "Padyshim që sigurimet shëndetësore janë shumë të rëndësishme dhe ato janë edhe zotim i yni. Ligjin për Sigurime Shëndetësore jemi duke e përgatitur dhe nëse jo në mbledhjen e ardhshme, e cila mbahet nesër, atëherë në mbledhjen tjetër të radhës së Qeverisë do të jetë për miratim dhe më pastaj do t'i ndjekë procedurat për Kuvendin e Kosovës. Duhet ta kemi edhe një

gjë parasysh se kur të bëhen sigurimet shëndetësore tek qytetari do të ketë një kosto shtesë sepse sigurimet shëndetësore nënkuptojnë që të paguajmë paraprakisht për atë që eventualisht mund të na ndodhë më vonë", u shpreh Kurti.

Kryeministri shtoi se qytetarët nuk duhet t'i shohin ato si "një shkop magjik që do të na parandalojë sëmundjet". "Nuk është që sot qytetarët paguajnë tepër shumë dhe rrjedhimisht sigurimet shëndetësore janë ato që do të na bëjnë të paguajmë më pak. Në fakt, fillimisht, sidomos do të jetë e kundërta. Do të na duhet që të paguajmë njëherë në mënyrë që të mos paguajmë më vonë. Nuk duhet parë sigurimet shëndetësore si një lloj shkopi magjik, i cili do të na i parandalojë sëmundjet ose do të na i eliminojë ato nëse i kemi", tha Kurti.



Ai shtoi se buxheti për shëndetësi krahasuar me vitin e para parapandemik 2019 tash që po flasim në 2024 është 50% më i lartë. "Dhe kjo natyrisht nuk është një shumë e cila i dedikohet mjekëve dhe infermierëve sa i dedikohet

pacientëve. Lista esenciale e barnave nga 24 milionë euro që e kemi gjetur si buxhet në vitin 2021 në vitin 2024 është 60 milionë euro, pra ngritje 150%. Përafërsisht në Kosovë blihen 120 milionë euro barna në vit. Tash gjysmën e

kostos e bart shteti e gjysmën qytetari", tha Kurti.

E ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se fillimisht duhet të sigurohen investimet e më pastaj të fillohet me implementimin e sigurimeve shëndetësore.

Kurti kërkon nga kryetari i Baden bei Wien vendosjen e gjuhës shqipe në institucionet arsimore

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të martën në zyrën e tij kryetarin e Komunës së Baden bei Wien në Austri, Stefan Szirucsek, i cili u shoqërua nga anëtari i këshillit të qytetit, Nusret Bujari.

Kryeministri Kurti e uroi kryetarin Szirucsek për binjakëzimin e suksesshëm të komunave Baden dhe Suharekë, duke shprehur krenarinë e tij për integrimin e mirë të shqiptarëve të Kosovës në Baden dhe rolin e rëndësishëm të shoqatës "17 Shkurt" në këtë drejtim.

Gjatë takimit, Kurti falënderoi kryetarin Szirucsek për mbështetjen që Austria i ka dhënë Kosovës, veçanërisht gjatë dhe pas luftës, dhe për njohjen e diplomave nga Kosova.

Ai theksoi marrëdhëniet shumë të mira kulturore, politike dhe historike ndërmjet Kosovës dhe Austrisë.

Gjithashtu, Kurti falënderoi Nusret



Bujari për punën e tij si anëtar i këshillit të qytetit në Baden dhe për rolin e tij si urë lidhëse ndërmjet Kosovës dhe Baden.

Nga ana e tij, kryetari Szirucsek vlerësoi praninë e sipërmarrësve nga Kosova në Baden dhe përmendi trashëgiminë botërore të qytetit të tij, duke shprehur dëshirën për të forcuar më tej marrëdhëniet, veçanërisht në fushën e turizmit, ku ka pasur një rritje prej 50% të netëve të kaluara në Kosovë gjatë vitit të kaluar.

Kryeministri Kurti përmendi rëndësinë e mësimin të gjuhës shqipe në shkollat e Baden dhe diskutoi mundësitë për ta vendosur atë në institucionet arsimore të qytetit.

Ai gjithashtu theksoi pjesëmarrjen e kompanive nga Baden në forumin e ardhshëm ekonomik Austri-Kosovë, që do të mbahet në Kosovë, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve.

Bregu: Besueshmëria e rajonit është në rrezik

TIRANË, 27 GUSHT - Besimi i qytetarëve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian ka rënë dukshëm, duke shënuar pikën më të ulët në gjashtë vitet e fundit. Kështu ka thënë në Konferencën e Ambasadorëve Diplo 2024 në Tiranë, Sekretarja e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, Majlinda Bregu "Stabiliteti i rajonit tonë qëndron në besimin në perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Mjerisht ky besim është lëkundur pasi,

sipas të dhënave ende të papublikuara të Balkan Barometrit, mbështetja për BE-në ka qenë në nivelin më të ulët në 6 vitet e fundit, me vetëm 54%", ka thënë Bregu.

Megjithatë, ajo ka shtuar se e mira është se besimi në bashkëpunimin rajonal, si parakusht i integritimit të suksesshëm në BE është në masën 80%. "Për të arritur integrimin në BE, ne kemi nevojë për një bashkëpunim të suksesshëm rajonal. Ndërsa

kemi parë njëfarë progresi, nevojitet zbatim i plotë i angazhimeve të marra, pasi inkurajimi i lëvizjes së lirë të fuqisë punëtore midis Ballkanit Perëndimor mund të sjellë një rritje prej 1.3% të PBB-së", ka thënë Bregu.

Më tej, ajo ka thënë se besueshmëria e rajonit është në rrezik dhe bllokimet dhe vonesat e vazhdueshme në zbatimin e detyrimeve dhe angazhimeve do të kenë kosto të larta.





Çfarë duhet të dinë qytetarët e Ballkanit Perëndimor për rregullat e reja të hyrjes në BE?

Prishtinë, 27 gusht- “Mirëdita! Pasaportat, ju lutem! Duhet t’ju marrim edhe gjurmë të së paku katër gishtërinjve. Edhe fotografi. Faleminderit dhe ju uroj qëndrim të këndshëm!”.

Kështu do të duhej të dukej nga 10 nëntori i këtij viti hyrja në Bashkimin Evropian dhe në Zvicër, Norvegji, Islandë e Lihtenshtajn - vende anëtare të zonës së lëvizjes së lirë Schengen për qytetarët e rreth 60 vendeve, përfshirë edhe ata të Ballkanit Perëndimor.

Në atë kohë do të fillojë të funksionojë sistemi i ri i hyrje-daljeve (Entry/Exit System - EES), i cili është krijuar në nëntor të vitit 2017, por se zbatimi i tij është shtyrë disa herë.

Për verën e ardhshme është paralajmëruar zbatimi edhe i Sistemit të dytë Evropian të Informacionit dhe Autorizimit të Udhëtimit (ETIAS), i cili u kërkon udhëtarëve nga vendet që kanë regjim pa viza me BE-në, të aplikojnë online për lejen e hyrjes, duke paguar një tarifë prej shtatë eurosh me kartelë bankare.

Pasaportat në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë biometrike, çipat e tyre përmbajnë shtatë gishtash dhe fotografi - çfarë i bën plotësisht në përputhje me kushtet që ka kërkuar BE-ja në mënyrë që vendet e Ballkanit Perëndimor të kenë regjim pa viza. Kushtet e përgjithshme - që dokumentet e udhëtimit të mos skadojnë në më pak se tre muaj nga data kur personi planifikon të kthehet në vendin e tij ose që

pasaporta të mos jetë më e vjetër se dhjetë vjet - do të vazhdojnë të mbeten në fuqi.

Cilat janë ndryshimet e reja nga mesi i vitit 2025?

ETIAS do t’u kërkojë qytetarëve të rreth 60 vendeve të plotësojnë një formular të veçantë nëpërmjet internetit ose aplikacionit celular, përpara se të udhëtojnë.

Me rastin e plotësimit të aplikacionit për herë të parë, pasagjeri fut të dhënat personale, emailin dhe numrin e telefonit, si dhe detajet e dokumentit të udhëtimit.

Udhëtari do të duhet, gjithashtu, të fusë detaje rreth arsimit dhe punësimit aktual, si dhe detaje rreth udhëtimit të planifikuar dhe qëndrimit në vendin e BE-së.

Do të kërkojnë edhe detaje për çdo dënim penal, për udhëtime në të kaluarën në zona lufte ose zona konflikti, si dhe informacione nëse personi është dëbuar nga ndonjë vend.

Udhëtarët do të duhet të paguajnë edhe një tarifë shtesë prej shtatë eurosh, me kartelë bankare. PAGESA DO TË BËHET SI PËR ÇDO BLERJE ONLINE. Tarifa nuk do të paguhet nga personat nën 18 vjeç dhe mbi 70 vjeç, bashkëshortët/partnerët e regjistruar dhe fëmijët e shtetasve të BE-së dhe të vendeve të zonës Schengen, si dhe fëmijët e bashkëshortëve/partnerëve që vijnë prej jashtë BE-së.

Aplikimi “grupor” nuk do të jetë i mundur - pra në rast të udhëtimit familjar, çdo anëtar do të duhet të aplikojë veçmas për ETIAS-in.

Sistemi ETIAS do të jetë i disponueshëm në gjuhët e vendeve anëtare dhe sistemi do të pranojë vetëm shkronja latine. Udhëtari do të mund të ndalojë plotësimin e aplikacionit, t’i ruajë ndryshimet dhe të vazhdojë të fusë të dhëna brenda 48 orësh.

Sa kohë duhet për t’u përpunuar një kërkesë?

Siç thuhet në faqen zyrtare të sistemit ETIAS, përpunimi duhet të zgjasë “disa minuta”. Nëse zgjat më shumë, pasagjeri duhet ta marrë njoftimin brenda katër ditësh.

Pasagjerëve mund t’u kërkojnë edhe informacione ose dokumente shtesë - si për shembull konfirmimi i rezervimit të hotelit dhe konfirmimi i punësimit - të cilat duhet të dorëzohen brenda dhjetë ditësh. Në atë rast, kërkesa duhet të shqyrtohet brenda dy javësh.

Udhëtari mund të ftohet për intervistë në ambasadën e vendit ku planifikon të udhëtojë dhe në atë rast kërkesa shqyrtohet brenda 30 ditësh.

Prandaj, udhëtarët këshillohen që ta plotësojnë formularin së paku një muaj përpara se ta blejnë biletën apo ta rezervojnë akomodimin.

Nëse udhëtari i lejohet hyrja në BE, ai do ta marrë njoftimin me email.

Leja ETIAS do të jetë e vlefshme për tre vjet, ose derisa të zëvendësohet dokumenti i udhëtimit me të cilin udhëtari ka aplikuar.

Formulari është i lidhur me dokumentin e udhëtimit, që do të thotë se është i vlefshëm vetëm me pasaportën me të cilën ka aplikuar udhëtari.

Pasaporta e re nënkupton aplikim të ri.

Nëse ETIAS-i paguhet dhe miratohet për udhëtimin në një vend, ai është gjithashtu i vlefshëm edhe për një vend tjetër.

Leja ETIAS nuk do të thotë që një person mund të qëndrojë në BE për më shumë se 90 ditë në një periudhë gjashtëmuajore, ose të punojë në BE.

Udhëtari do të mund të hyjë dhe të dalë nga BE-ja sa herë të dojë dhe të udhëtojë në çdo destinacion brenda zonës Schengen gjatë periudhës së vlefshmërisë së lejes dhe për aq kohë sa ai e respekton afatin e specifikuar kohor.

Çfarë nëse personi nuk ka internet, kartelë bankare, është analfabet dhe të ngjashme?

Prindërit e plotësojnë formularin për fëmijët e tyre të mitur, të cilët janë të përjashtuar nga pagesa e tarifës prej shtatë eurosh. Gjithkush mund të autorizojë një palë të tretë - një person tjetër ose një ndërmjetës tregtar - që të aplikojë në emër të tij ose në emër të fëmijëve të tij të mitur.

Me një ndërmjetës - për shembull nga një agjenci udhëtimesh - deklarata e përfaqësimit duhet të nënshkruhet për çdo person individualisht dhe e njëjta gjë vlen në rast se një mik, fqinj, vajza ose djali aplikon për një person.

Personi ose kompania që është ndërmjetëse, do të duhet, gjithashtu, t’i fusë të dhënat e veta. Ndërmjetësi ka të drejtë të kërkojë një “tarifë të arsyeshme” dhe BE-ja ka parashikuar mundësinë e raportimit anonim të atyre që kërkojnë pagesa të larta.

Ata që vendosin të aplikojnë përmes një ndërmjetësi, këshillohen të kontrollojnë veçanërisht nëse informacioni në aplikacion është i saktë, përpara se ta dërgojnë atë, sepse në rast të ndonjë gabimi, aplikacioni mund të refuzohet ose anulohet.

Në rast se udhëtari vëren ndonjë gabim, ai mund ta plotësojë një aplikacion të ri ose të kërkojë korrigjimin e gabimit në aplikacionin e vjetër. Procedura e përpunimit në atë rast zgjat deri në 30 ditë.

Si të shkoni në një funeral, të vizitoni prindin që është shtetas i BE-së dhe të ngjashme?

Formulari ETIAS nuk do të duhet të plotësohet nga personat që kanë vizë të vlefshme - studentore, pune ose të ngjashme - ose leje qëndrimi në një vend të BE-së. Formulari nuk plotësohet as nga personat që

Opozita: 4 vjet në qeverisje, pagat rriten me 6.8 euro. Thaçi 10 vjet më parë i kishte dyfishuar

PRISHTINË, 27 GUSHT - Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se katër vjet të Kurtit në qeverisje pagat rriten me 6.8 euro. "Krejt politikat fiskale të Qeverisë Kurti përmbledhen në uljen e tatimit në paga për 6.8 euro, i cili hyn në fuqi nga shtatori. Ja sa "të thella" janë politikat fiskale në këtë mandat qeverisës!!! Vendi është varfëruar pasi inflacioni i ka ulur pagat reale me rreth 1/3. Pagat në sektorin publik nuk janë rritur, së paku nominalisht për t'u mbrojtur nga inflacioni. As pensionet dhe përfitimet e tjera nuk janë rritur, përjashtoj ndihmat e njëhershme. Por energjia dhe tatimi në pronë janë rritur, së bashku edhe me rritjen enorme të çmimit të ushqimeve", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Ai ka theksuar se zhvillimi ekonomik ka ngecur në mungesë të investimeve të mëdha publike, si rrugët rajonale, termocentrali me gaz e hekurudhat. "Rreth 1 miliard euro nga totali i mjeteve të planifikuara në investime kapitale nuk janë shpenzuar. Investimet e komunave, sado që janë të vogla, janë penguar përmes vonësive në alokimin e mjeteve nga Qeveria.



Investimet e jashtme janë reduktuar në shpenzimet e mërgimtarëve kryesisht në

patundshmëri, pasi investime nga kompanive të huaja pothuajse nuk ka fare. Kjo është e

kuptueshme pasi Kurti dhe koalicioni i tij me Osmanin dhe të tjerët e kthyen Kosovën në

problem të sigurisë për aleatët. Qasja e tyre, e bazuar në agenda politike lokale dhe e paakorduar me aleatët, e bllokoi agjendën euro-integruese të Kosovës, i bllokuan njohjet e reja dhe anëtarësimet në organizma ndërkombëtarë dhe e ktheu Kosovën prapa. Sot, Kosova shihet nga aleatët jo si një vend me sfida për integrim euro-atlantik, por si një vend me sfida të sigurisë rajonale, ku duhet rritur praninë e KFOR-it, e duhet vizituar nga zyrtarët më të lartë të inteligjencës", ka shkruar Hoti.

Edhe deputetja e PDK-së, Blerta Deliu, ka komentuar rritjen e pagës nga qeveria Kurti për 6.8 euro. Ajo ka thënë se saktësisht 10 vjet më parë, ish-krayeministri Hashim Thaçi i kishte dyfishuar pagat e sektorit publik në Kosovë. "Për shembull, paga e një polici ishte bërë nga 247 euro, në 589 euro. Sot, Qeveria i paska rritur pagat për 6.8 euro - të cilat ua paska marrë mbrapa duke ua rritur edhe tatimin mbi pagë. Shumë mirë. Tamam reflektim i fuqisë, punës dhe vizionit të saj. Përparim se jo mahi", ka shkruar Deliu në "Facebook".

jetojnë përgjatë kufirit dhe posedojnë kalime kufitare.

Anëtarët e ekuipazhit në anije dhe avionet për disa vende të BE-së do të kenë nevojë për formularin ETIAS.

Përjashtime bëhen në rast të rrezikimit të jetës së aplikuesit apo të të afërmit, vajtes në varrim të një familjari, detyrimit për t'u paraqitur në gjykatë apo ndonjë "detyrimi të rëndësishëm".

Në atë rast, udhëtari e plotëson aplikacionin ETIAS për të ashtuquajturën leje të kufizuar që e tregon arsyen.

Leja lëshohet nga shteti në të cilin personi udhëton dhe është e vlefshme për të udhëtuar vetëm në atë vend për maksimum 90 ditë.

Për shembull, nëse bëhet fjalë për të shkuar në një funeral, një vend i BE-së mund ta lejojë hyrjen vetëm për ditët e varrimit.

Nëse personi, ndërkohë, aplikon dhe merr një ETIAS të dytë për udhëtim në të gjitha vendet e Schengenit, leja e kufizuar

automatikisht bëhet e pavlefshme.

Çka nëse BE-ja refuzon t'ju japë leje?

Personave pa autorizimin ETIAS do t'u refuzohet hyrja në kufi. Edhe marrja e kësaj certifikate nuk nënkupton që udhëtarit do t'i lejohet automatikisht hyrja në vendin e BE-së.

Të gjithë udhëtarët do të kontrollohen dhe një oficer kufitar mund t'ia refuzojë hyrjen një personi që nuk i plotëson kërkesat.

Disa nga kushtet për hyrje janë: dokument i vlefshëm i udhëtimit për së paku tre muaj nga data e kthimit të planifikuar; pasaporta të mos jetë më e vjetër se dhjetë vjet; qëndrimi të jetë i justifikuar dhe personi të ketë para të mjaftueshme deri në kthimin e planifikuar.

Tajlanda është bërë vendi i fundit që ka hequr vizat për shtetasit e

Kosovës. Kosovarët tani mund të udhëtojnë pa viza në 51 shtete të botës, ndërsa në 39 vende mund të pajisen me viza sapo të mbërrijnë.

Shuma e zakonshme është rreth 100 euro në ditë dhe varet nga shteti anëtar i BE-së.

Disa nga arsyet e refuzimit të hyrjes lidhen me kërcënimet për sigurinë ose shëndetin.

Nëse kërkesa për ETIAS refuzohet, revokohet ose anulohet, personi do ta marrë një email që i tregon arsyet e refuzimit dhe emrin e autoritetit që e ka marrë vendimin. Ekziston mundësia e apelimit dhe emaili do të përmbajë informacione se në cilin vend ose shtet mund të apelohej. Ankesat trajtohen në përputhje me ligjet e atyre vendeve.

Një person, aplikimi i të cilit refuzohet, mund të aplikojë sërish për lejen ETIAS. Nëse një person e revokon kërkesën e tij, ai nuk mund të ndryshojë mendje më pas, por duhet të plotësojë një

formular të ri.

Tarifa nuk rimbursohet nëse aplikacioni refuzohet.

A do të ketë më shumë tollovi në kufij?

Me futjen e EES-it, mbetet skanimi i dokumenteve të udhëtimit, ndërsa vulosja e pasaportave në pikën kufitare ndalon.

Megjithatë, marrja e shenjave të gishtërinjve dhe fotografimi, që do të bëhen në çdo pikë kufitare, mund t'i zgjasin pritjet në radhë. Në aeroporte, kontrollet do të kryhen pas aterimit.

Shtetet anëtare i kanë ndryshuar disa ligje për t'i reduktuar tollovitë e mundshme në vendkalimet tokësore.

Pse është krijuar ky sistem?

Sistemi i ri EES është krijuar për t'i bërë bazat e vendeve anëtare të BE-së më të lidhura, për ta lehtësuar gjurmimin e kohës dhe

vendit të qëndrimit dhe për të siguruar që udhëtarët nuk qëndrojnë më shumë se 90 ditë brenda një periudhe gjashtëmuajore.

Një nga qëllimet e masave të reja është të vështirësohet hyrja e kriminelëve apo terroristëve në BE me pasaporta false, pasi kontrolli biometrik do të kryhet sa herë që kalohet kufiri.

Pasagjerët nuk do të paguajnë tarifë për ofrimin e të dhënave biometrike.

Të dhënat do të jenë të qasshme për shërbimet policore të vendeve anëtare të sistemit Schengen dhe agjencinë policore, EUROPOL, gjatë hetimeve penale, sidomos terrorizmit dhe krimin të organizuar.

Kontrollet e të dhënave biometrike do të rriten në mes të vitit 2025, por data e saktë nuk është përcaktuar. Sisteme të ngjashme kanë krijuar tashmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja dhe Australia.

(Përgatiti: Valona Tela / REL)

Mexhiti: Pas 22 viteve sollëm ndryshimin te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut

TIRANË, 27 GUSHT - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministër i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Izet Mexhiti, ka marrë pjesë në Konferencën e Ambasadorëve në Tiranë, të organizuar nga Ministria për Evropë dhe Punë të Jashtme e Republikës së Shqipërisë ku prezent ishin politikanë shqiptarë nga vendet e rajonit.

Gjatë panelit me temë "Hapësira shqiptare në gjeopolitikën e rajonit", zëvendëskryeministri i parë Mexhiti ndau pikëpamjet mbi

zhvillimet e fundit në skenën politike të Maqedonisë së Veriut, ku theksoi rëndësinë e ndryshimit të shumëpritur që sollë krijimi i qeverisë pa BDI-në, një parti që për 22 vjet kishte monopolizuar politikën shqiptare, ndërsa partitë maqedonase ndryshoheshin vazhdimisht, duke nënvizuar se BDI-ja kishte ngulfatur skenën politike dhe pengonte çdo përpjekje për ndryshime pozitive për shqiptarët.

Mexhiti tha se integrimi evropian mbetet prioriteti absolut i koalicionit, dhe

shprehu përkushtimin dhe gatishmërinë për votimin e ndryshimeve kushtetuese në çdo moment.

Zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut ka përgëzuar ministrin Igli Hasani për krijimin e një departamenti të veçantë në Ministrinë e Jashtme të Shqipërisë, dedikuar shqiptarëve të rajonit dhe diasporës, duke shtuar se thellimi i bashkëpunimit brendashqiptar është një domosdoshmëri që duhet të vazhdojë pandërprerë.



Mexhiti nënvizoi nevojën e krijimit të një platforme të përbashkët bashkëpunimi në fusha të ndryshme, nga arsimit

deri te ekonomia, duke e cilësuar këtë si një element përcaktues për të ardhmen tonë të përbashkët evropiane.

Totaj ia dorëzon projektbuxhetin e 2025-s kryesueses së Kuvendit Komunal

PRIZREN, 27 GUSHT - Pas një periudhe intensive dëgjimesh publike dhe angazhimi të gjithanshëm me qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-ve, shoqatave dhe biznesit, Komuna e Prizrenit ka njoftuar për përfundimin e projektit të buxhetit për vitin 2025, i cili projekt është bërë duke marrë parasysh të gjitha kërkesat, sugjerimet dhe idetë e qytetarëve si dhe është finalizuar me energji dhe përkushtim nga grupi i

zyrtarëve komunalë të angazhuar në hartimin e buxhetit. Dëgjimet publike u kanë ofruar mundësi qytetarëve të kontribuojnë në formimin e qëndrimeve dhe të krijojnë një bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Prizrenit. Ky proces ka qenë thelbësor për të siguruar që buxheti t'i reflektojë nevojat dhe prioritetet e komunitetit. Kryetari Shaqir Totaj ia dorëzoi projekt buxhetin

kryesueses së Kuvendit Komunal, Antigona Bytyqi, e cila do të vazhdojë me procedurat e nevojshme ligjore deri në miratimin përfundimtar të buxhetit për vitin 2025 nga anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit. Pas miratimit në Kuvend, buxheti do të publikohet në uebfaqen zyrtare të Komunës së Prizrenit, për transparencë dhe qasje të gjerë për të gjithë qytetarët.



Përurohen investimet rreth 800 mijë euro në Klinikën Emergjente të QKUK-së

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 GUSHT- Kryeministri Albin Kurti, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Haxhi Avdyli, të shoqëruar nga drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, morën pjesë të martën në përrimin e renovimeve të Klinikës Emergjente brenda QKUK-së.

Nga investimet, kostoja e të cilave arriti shumën rreth 800 mijë euro, kryeministri Kurti cilësoi se sot duket që nuk është e mundshme të njihet Klinika Emergjente për shkak të transformimit rrënjësor që ka përjetuar së brendshmi. "Kemi triazhimin, hapësirën për triazhim, kemi riorganizim të

sportelit, kemi nje sanitare dhe banjot e rregulluara dhe gjithashtu rritjet e numrit të shtretërve nga 20 në 25", tha ai. Në prononcimin e tij kryeministri shpjegoi se tashmë me renovimet e bëra, mjekësia dhe telemjekësia janë të integruara në një, falë kamerave që mundësojnë përcjelljen e operimeve në kohë reale. "Në sallën e operimit pamë që tek ndriçimi ekzistojnë edhe kamerat, që do të thotë se operimi mund të përcjellët në kohë reale edhe nga ndonjë konzolium i mjekëve, i kirurgëve që ndodhet jashtë Qendrës Klinike Universitare, në këtë mënyrë mjekësia dhe telemjekësia janë të integruara në një, ashtu si janë ndriçimi i këndshëm e profesional me



kamerën e cila e përcjellë në kohë reale operimin e pacientit apo të aksidentuarit", deklaroi kryeministri Kurti. Ndër të tjera, shtoi se pacientët në

Klinikën Emergjente do t'i kenë shanset maksimale për shërim dhe për shpëtim, sepse i kemi mjekët e infermierët të përkushtuar bashkë me kushtet e

dinjitetshme dhe moderne të punës. "Ky investim në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është një lloj mirënjohje e jona për profesionalizmin dhe për devotshmërinë e këtij stafi ndër shumë e shumë vite në kushte në të cilat kanë qenë kundër tyre e jo në shërbim të tyre", përfundoi kryeministri, duke falënderuar personelin shëndetësor. Ndërkaq, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se këto investime dhe procese jemi duke i kaluar jo vetëm në QKUK, por edhe me investime edhe në spitalet regjionale, edhe me përzgjedhjen e mjekut familjar që tash po bëhet në mjekësinë primare, edhe me ngritjen e buxhetit për barna edhe në primare edhe në sekondar e terciare, si dhe në funksion edhe të sigurimeve shëndetësore.

Hyseni: Zgjerimi i rrugës 'Hamdi Kurteshi' një nga projektet më të rëndësishme infrastrukturore



GJILAN, 27 GUSHT- Po vazhdojnë punimet në zgjerimin e rrugës "Hamdi Kurteshi", njërit prej projekteve më të mëdha në vlerë 2.4 milionë euro. E si shkak i punimeve nga dita e mërkurë, më 28 gusht një pjesë e rrugës do të jetë e bllokuar për qarkullim. Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, tha se zgjerimi i rrugës "Hamdi Kurteshi", është një nga projektet më të rëndësishme infrastrukturore për komunën tonë dhe për qytetin e Gjilanit.

Më tej ai shtoi se në vlerë prej 2.4 milionë euro dhe me gjatësi rreth 1 kilometër, po mbulohet shtrati i lumit, respektivisht po përgatitet kolektori me gjerësi prej rreth 5 metrave dhe thellësi prej 2 metrave. I pari i komunës, tregon se kjo rrugë do të jetë me katër korsi, me trotuar në dy anë e rrugës, me shteg për biçikleta dhe shirit për këmbësorë. "Aktualisht jemi në fazën ku një segment i rrugës duhet të mbyllet, në mënyrë që të vazhdohen punimet", tha Hyseni, duke

treguar se nga ura ku po vazhdohen punimet tani, deri te kthesa e parë në të majtë rruga do të jetë e bllokuar. Sipas tij për të mos bllokuar tërësisht qarkullimin është asfaltuar një rrugë alternative. Përmes saj nga rruga e Malishevës, mund të kalohet direkt në rrugën e Bujanocit, duke mundësuar kështu lidhjen me të gjitha rrugët e qytetit. "Për infrastrukturë moderne, hapësira për këmbësorë dhe siguri në komunikacion", tha kryetari Hyseni.

Edhe një shkollë e kryeqytetit kyçet në Termokos

Prishtinë, 27 gusht- Shkolla "Shtjefën Gjeçovi" është bërë pjesë e projektit për një Prishtinë më të pastër dhe më të qëndrueshme, duke u bërë institucioni i 23-të arsimor që lidhet me

sistemin e ngrohjes së qytetit. "Deri tani, kjo shkollë ka shpenzuar mbi 27,000 litra naftë, me një kosto prej rreth 34,000 euro. E nga ky vit e tutje, shkolla jo vetëm që do të kursejë këto shpenzime,

por gjithashtu do të eliminojë ndotjen e mjedisit nga përdorimi i naftës. Termokos-i po e transformon Prishtinën në një qytet më të gjelbër dhe pastër!", ka bërë me dije kryetari Rama.



Pse shkalla e punësimit të grave në Kosovë është aq e ulët?



PRISHTINË, 27 GUSHT - Mbi 80 për qind e grave në Kosovë nuk janë pjesë e tregut të punës, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

Por, për studiuese si Ernera Dushica nga Instituti për Studime të Avancuara GAP dhe Blenda Asllani nga Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion QIKA, kjo statistikë nuk reflekton realitetin. Ato argumentojnë se gratë kryejnë shumë punë, por se ato nuk u njihen formalisht.

Që kur ASK-ja ka filluar grumbullimin e të dhënave për shkallën e punësimit të qytetarëve të Kosovës në vitin 2012, burrat kanë qenë të punësuar në shkallë dukshëm më të larta se gratë.

Muajin e kaluar u publikua Anketa e fundit e Fuqisë Punëtore, ku shihet se mbi 53 për qind e burrave në Kosovë dhe më pak se 20 për qind e grave janë të punësuar.

Në Kosovë, shkalla e punësimit të burrave ka qenë gjithmonë dukshëm më e lartë se shkalla e punësimit të grave. Edhe në periudhat kohore kur ka pasur ngritje të kësaj shkalle të të gjithë, trendi ka qenë më i dukshëm në mesin e burrave.

Tregu joformal i punës

Matja e shkallës së punësimit në Kosovë vlerësohet si proces i vështirë për shkak të tregut joformal të punës.

Shumë qytetarë të Kosovës nuk marrin kontrata pune dhe nuk regjistrohen si punëtorë në kompanitë ku punojnë. Në shumë raste, kjo bëhet për të mos

e humbur asistencën sociale mujore apo për t'iu shmangur pagimit të taksave.

Gjithsej, 42 për qind e kosovarëve vlerësohet se janë të përfshirë në tregun joformal të punës, sipas një studimi të sivjetmë të Rrjetit të Grave të Kosovës (RRGK). Më të cenuarat rezultojnë të jenë gratë që jetojnë në zonat rurale.

Gratë kanë pothuajse dyfish më shumë gjasa se burrat në Kosovë të jenë të punësuar në tregun joformal. Të cenueshme janë veçanërisht gratë e moshës 46-64 vjeç nga zonat rurale.

Dushica nga Instituti GAP thotë se puna joformale e grave në zonat rurale përfshin punën në fermat familjare, ku gratë ndihmojnë në kultivimin e tokës, përkujdesen për kafshë apo përpunojnë produkte bujqësore. "Në zonat rurale, shumë gra punojnë në bujqësi. Shumë shpesh janë të papaguara dhe nuk gëzojnë mbrojtje sociale", thotë Dushica për REL-in.

Këtë e tregojnë edhe të dhënat e raportit të RRGK-së, sipas të cilave gratë në zonat rurale kanë dukshëm më shumë gjasa të kryejnë punë të papaguar në biznese familjare.

Ndër dëmet më të mëdha për gratë të cilave nuk u njihet puna e tillë, Dushica vlerëson se është pensioni mujor që ato marrin pas moshës 65 vjeç.

Pa pasur kontribut të njohur në tregun e punës, gratë nga moshja 65 vjeçe marrin vetëm pensionin bazik të moshës, që është 100 euro në muaj.

Pension më të lartë - atë si kontributdhënës - gëzojnë ata persona që kanë qenë aktivë në tregun formal të punës.

Barra e kujdesit për fëmijë, të moshuar dhe shtëpi

Por, përveç punës së papaguar në biznese familjare, Asllani nga organizata QIKA thekson edhe punën e kujdesit shtëpiak dhe familjar, ku gratë janë më të angazhuara se burrat. Sipas saj, faktorët e tillë që ndikojnë në shkallën e ulët të punësimit, kanë në thelb "normat patriarkale dhe stereotipat e bazuar në gjini". "Arsyeja kryesore është se shoqëria jonë, tradicionalisht, i ka parë dhe i sheh gratë si përgjegjëset kryesore për kujdesin ndaj familjes dhe shtëpisë, respektivisht si përgjegjëset kryesore për punën e papaguar të kujdesit - çka i detyron ato të qëndrojnë në shtëpi", thotë Asllani për Radion Evropa e Lirë.

Në Kosovë, sipas të dhënave të publikuara në tetor të vitit 2022 nga Instituti Musine Kokalari, puna e papaguar e kujdesit shtëpiak arrin vlerën mbi 1.8 miliard euro.

Ai raport tregon se gratë kalojnë mesatarisht 6.2 orë në ditë duke u përkujdesur për familjarë apo për shtëpi, ndërsa burrat 3.5 orë.

Raporti i sivjetmë i RRGK-së tregon se edhe burrat, edhe gratë ndihen të mbingarkuar nga puna në shtëpi - gjë që i shtyn të mos jenë aktivë në tregun e punës.

Por, për gratë, arsyeja e dytë më e shpeshtë është kujdesi për familjarë, në krahasim me burrat që kanë dhënë si arsye studimet akademike. Puna në shtëpi është arsyeja kryesore që gratë dhe burrat e papunësuar në Kosovë e kanë dhënë si shkak për mosangazhimin e tyre në tregun e punës. Për gratë,

arsyeja e dytë më e shpeshtë është kujdesi për fëmijë, ndërsa për burrat janë studimet akademike.

Sipas Asllanit, mungesa e të ardhurave që do të sillte puna formale te gratë, bën që ato të kenë më pak mundësi të investojnë për ngritjen e tyre akademike apo profesionale.

Por, kjo mungesë e të ardhurave shkakton edhe varësi financiare të grave ndaj partnerëve apo familjarëve të tyre, shton ajo. "Varësia financiare krijon raporte të pabarabarta të pushtetit, duke kufizuar kështu pavarësinë e grave për t'i marrë vetë vendimet për jetën e tyre. Së dyti, rrit rrezikun e grave për të qenë viktime të dhunës dhe abuzimit nga partnerët apo familjarët", shpjegon Asllani.

Kjo, sipas saj, ndodh për faktin se në pamundësi që të financojnë një jetë të pavarur, shumë gra detyrohen të qëndrojnë në marrëdhënie abuzive.

Të dhënat tregojnë se gratë në Kosovë janë më pak aktive edhe në kërkim të vendeve të punës, në krahasim me burrat.

Dallimi më i madh në shkallën e punësimit të burrave dhe grave vërehet në grup-moshën 35-44 vjeçe, kur shumë prej tyre bëhen prindër.

Për këtë arsye, Dushica dhe Asllani propozojnë që të ndryshohet pushimi i lehonisë me një pushim prindëror.

Nënave lehona në Kosovë u takojnë 12 muajt pushim, prej të cilëve nëntë muajt e parë janë me pagesë.

Në anën tjetër, babai i fëmijës ka të drejtë vetëm në dy ditë pushim me pagesë pas lindjes së fëmijës dhe dy javë pushim të papaguar. Të drejtat e pushimit të nënës mund të barten te babai i fëmijës vetëm

në rastet kur nëna vdes, braktis fëmijën ose prindërit merren vesh mes vete.

Ndryshimi i kësaj skeme është në plan të Qeverisë që një kohë, por ai nuk është finalizuar asnjëherë.

Në tetor të vitit 2022, Inspektorati i Punës, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka thënë se ndryshimi i kësaj skeme të pushimit prindëror është përfshirë në draftin e ri të Ligjit të Punës.

Megjithatë, këto ndryshime nuk i kanë kaluar ende procedurat e nevojshme ligjore për të hyrë në fuqi.

Dushica argumenton se ndarja e pushimit pas lindjes së fëmijës mes dy prindërve do ta ulte diskriminimin ndaj grave në tregun e punës. "Pastaj, një punëdhënës nuk do të mendonte a të punësojë një grua apo jo, për shkak se ajo mund të shkojë në pushim të lehonisë, pasi që do ta dinte që edhe nëse e punëson një grua apo një burrë, të dy do ta merrnin një pushim prindëror", thotë Dushica. Asllani, ndërkohë, propozon që inspektorët e punës të trajtohen për trajtimin e diskriminimit gjinor në tregun e punës dhe të krijohet një platformë ku diskriminimi i tillë mund të raportohet lehtësisht nga gratë.

Për më tepër, shton ajo, meqë gratë në Kosovë e mbajnë barrën kryesore për kujdes shtëpiak, ato duhet të përkrahen me politika specifike nga institucionet shtetërore. "Për ta lehtësuar përfshirjen e grave në tregun e punës, është thelbësore të investohet në infrastrukturën për kujdesin ndaj fëmijëve, duke krijuar kopshte dhe çerdhe me kosto të përbalueshme", thotë Asllani.

KEDS-i merr pjesë në sesionin e CIGRE në Paris



PRISHTINË, 27 GUSHT - KEDS-i po merr pjesë në sesionin e CIGRE në Paris.

Sesioni i kryeqytetit francez është ngjarja më e madhe globale që e organizon CIGRE (Këshilli Ndërkombëtar i Sistemeve të Mëdha Elektrike). Aty po marrin pjesë mbi 4500 delegatë nga e gjithë bota, mbi 280 ekspozues dhe mbi 10 mijë vizitorë.

Në këtë eveniment të

rëndësishëm prezantohen zhvillimet e fundit të sektorit të energjisë, teknologjitë më të fundit, si dhe paraqiten ekspertizat më të reja për sistemet elektroenergjetike.

KEDS-i ka theksuar se mbetet kompani e përkushtuar të ecë me hapin e kohës, ku përfshihet përqafimi i teknologjive të reja, sistemeve të avancuara dhe zhvillimeve të fundit në sektorin energjetik.

KEDS dhe KESCO ishin sponsorë platinum të konferencës së CIGRE, që ishte mbajtur në fund të vitit të kaluar në Prishtinë.

Në këtë konferencë, e cila është mbajtur nga 22 deri më 24 nëntor 2023, kishin marrë pjesë rreth 200 ekspertë të sektorit të energjisë dhe ishin prezantuar punime dhe diskutuar tema me rëndësi për sektorin e energjisë.

Ndryshohen shkallët e tatimit për të ardhurat personale

PRISHTINË, 27 GUSHT - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se më 23 gusht është publikuar në Gazetën Zyrtare Ligji Nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore. Ky ligj ka filluar të zbatohet nga data 23 gusht 2024.

“Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-142, me nenin 5 ndryshohen shkallët tatimore të cilat janë të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatim në të Ardhurat Personale. Më konkretisht, sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-142 bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatim në të Ardhurat



Personale, si në vijim, citojmë: ‘Neni 5: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale. Neni 6 i Ligjit Nr.

05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, ndryshohet si në vijim: Neni 6 - Shkallët e tatimit. 1. Tatimi në të ardhura personale vjetore,

ngarkohet sipas shkallëve në vijim: 1.1 Për të ardhurat e tatueshme deri në tremijë euro (3.000 euro), duke përfshirë edhe shumën tremijë euro (3.000

euro), zero për qind (0%); 1.2. Për të ardhurat e tatueshme mbi tremijë euro (3.000 euro), deri në pesëmijë e katërqind (5.400 euro), duke përfshirë edhe shumën pesëmijë e katërqind (5,400 euro), tetë për qind (8%) të shumës mbi tremijë euro (3.000 euro); dhe 1.3. Për të ardhurat e tatueshme mbi pesëmijë e katërqind (5,400 euro), njëqind e nëntëdhjetë e dy euro (192 euro) plus dhjetë për qind (10%) të shumës mbi pesëmijë e katërqind (5,400 euro)”.

Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se më apo para datës 1 shtator 2024 do të publikojë versionin e ri të sistemit elektronik EDI, përmes të cilit do të deklarohen dhe paguhet: Tatimi në Paga, Kontributet Pensionale dhe tatimet tjera nga personat fizikë afarist dhe jo-afarist, sipas shkallëve të reja tatimore.

Haradinaj premton që pensionet do të jenë 450 euro

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se pensioni prej 100 e sa eurosh nuk mjafton as për barnat bazike, duke i shtyrë shumë drejt varfërisë së skajshme.

Haradinaj ka thënë se qeveria e Kosovës e ka braktisur këtë kategori të shoqërisë. “Pensionistët e Kosovës përballen me situatë të rënduar ekonomike. Në bisedë me pensionistë dhe veteranë të arsimit në Vushtrri, u shpreh zhgënjim i thellë me gjendjen e tyre ekonomiko-sociale. Premtimet e pambajtura të katër viteve të fundit, janë treguesi i mashtrimit dhe i braktisjes së kësaj kategorie nga

Qeveria”, ka thënë Haradinaj. Haradinaj ka shtuar se pensioni prej 100 e sa eurosh nuk mjafton as për barnat bazike. “Pensionit prej 100 e sa eurosh nuk mjafton as për barnat bazike, duke i shtyrë shumë drejt varfërisë së skajshme. Ato më e pakta do të jenë në nivelin e pagës minimale, që arrijnë shifrën prej 450 euro. Projektioni ynë është që të sigurohet një buxhet dyvjeçar për fondin e sigurimeve shëndetësore për fillimin e zbatimit të ligjit për sigurime shëndetësore për të gjithë qytetarët. Ne besojmë në një Kosovë ku pensionistët gëzojnë kujdes të posaçëm, dhe ku çdo qytetar jeton me dinjitet”, është shprehur Haradinaj.



Hapet thirrja për izolimin e shtëpive

Prishtinë, 27 gusht - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka njoftuar se është hapur

thirrja për aplikime për investime në eficiencë të shtëpive. Rizvanolli ka njoftuar se

sipas parimit kush aplikon i pari shërbehet i pari, nga tash do të mund të aplikoni për përkrahje financiare deri

në 5,500 euro për të izoluar shtëpitë e çatitë tuaja dhe zëvendësuar dritaret e dyert e jashtme.



Filmi “Luftëtari i 13-të” dhe heroji mysliman

Nga: Mohammad ZAHEER / BBC
Përkthimi (i pjesshëm) nga: Telegrafi.com

U dha premierë në ShBA 25 vjet më parë, dhe Luftëtari i 13-të [The 13th Warrior] kishte të gjitha elementet e një filmi të suksesshëm të Holivudit. Kishte një yll të kategorisë së parë, Antonio Banderasin; u realizua nga regjisori i njohur i aksionit, John McTiernan (i njohur për hite të mëdha si Predator dhe Die Hard); dhe ishte bazuar në një roman magjepsës të shkruar nga autori i Parkut të Jurës [Jurassic Park], Michael Crichton, me titull Ngrënësit e të Vdekurve [Eaters of the Dead].

Ashtu si libri, i cili ishte një interpretim i lirë i Beovulfit, filmi tregoi historinë e Ahmad ibn Fadlanit – një diplomat arab i shekullit X, i mërguar nga Bagdadi, i cili pa dëshirë u bashkua me një grup vikingësh në rrugën e tyre për të luftuar një të keqe misterioze dhe të tmerrshme. Megjithatë, përkundër të gjitha këtyre elementeve, filmi u prit keq nga kritika dhe ishte një dështim komercial. Pas rixhirimeve të kushtueshme për shkak të rezultateve jo të mira nga ekranizimet testuese, buxheti u rrit në mbi 100 milionë dollarë (afro 90 milionë euro), ndërsa fitoi vetëm 61,7 milionë dollarë (55.2 milionë euro) në mbarë botën. Kritiku i filmit Roger Ebert, duke i dhënë atij një vlerësim prej 1.5/5, shkroi se filmi “shfaq shumë para në ekran, por pak mendime”.

Megjithëse prej kohësh është harruar nga pjesa më e madhe e publikut, filmi ka krijuar ndjekës të përkushtuar, veçanërisht mes myslimanëve që kërkojnë përfaqësim pozitiv në ekranin e madh. Përgjatë viteve, Holivudi ka qenë subjekt i kritikave të shpeshta për portretizimin negativ të myslimanëve dhe kulturës islame. Vlen të thuhet se edhe sot është e vështirë të gesh një shembull të një përshkrimi pozitiv ose të nuancuar të një protagonistit mysliman në një film, pa praninë e personazheve të këqij ose problematikë. Ekzistojnë disa biopikë për figura të rëndësishme myslimane, si Ali apo Malcolm X, dhe disa filma relativisht me buxhet më të vogël me protagonistë myslimanë (si Traitor dhe The Big Sick) që e kundërshtojnë këtë trend. Megjithatë, asnjë nga këta filma nuk kishte nivelin e burimeve të derdhura si Luftëtari i 13-të, duke e bërë dështimin e tij edhe më zhgënjyes dhe trashëgiminë e tij më të ndërlikuar.

“Si dikush që ka kaluar 20 vjet duke u përpjekur për të bërë

filma dhe shfaqje televizive që i vendosin identitetet myslimane në krye, mendoj se Luftëtari i 13-të ndoshta e rëndoi situatën sepse ishte një katastrofë kaq e madhe komerciale sa që disa njerëz në Holivud vendosën të mos bëjnë më filma me protagonistë myslimanë”, thotë Dr. Reza Aslan, autor bestseller, producent televiziv dhe profesor i shkrimit krijues në Universitetin e Kalifornisë. “Pastaj, pothuajse menjëherë ndodhën ngjarjet e 11 shtatorit, të cilat e lejuan Holivudin t’i kthente myslimanët në antagonistë”.

Tani, 25 vjet pas premierës së tij, filmi kërkon një rivlerësim, veçanërisht në dritën e kontributit të tij në përfaqësimin e myslimanëve në ekran.

“Legjenda thotë se Michael Crichton debatonte me një mik për vlerat e Beovulfit – veprës së parë të rëndësishme të letërsisë anglo-saksone – dhe në një bast vendosi se mund ta rishkruante atë për një audiencë moderne”, thotë Aslan. “Gjatë procesit të shkrimit, i ra në dorë dorëshkrimi i Ahmad ibn Fadlanit, që është përshkrimi i parë i huaj i kulturës vikinge – dhe aq u mahnit nga ai sa vendosi ta bënte protagonist të historisë së tij”.

Sipas Warren Lewisit, profesor i skenarit në Universitetin Shtetëror të Kalifornisë dhe një nga skenaristët e filmit, nuk kishte dyshim se besimi islam i personazhit do të ishte element qendror. Në fakt, u mendua shumë për ta prezantuar Ahmadin në një mënyrë më të respektueshme, dhe kjo është arsyeja pse versioni i personazhit që shohim në ekran është shumë i ndryshëm nga konceptet e mëparshme më komike, të cilat nuk u morën parasysh.

Nuk është e vështirë të kuptosh pse shumë shikues myslimanë tërhiqen drejt tij. I luajtur me dinjitet nga Banderasi, kur Ahmad vendoset në rrethana të pakëndshme me vikingët, kjo nuk përdoret vetëm për ta tallur, por përkundrazi, atij i jep shumë mundësi për të shkëlqyer me intelektin dhe trimërinë e tij. Kur vikingët tallen me madhësinë e kalit të tij, ai u lë përshtypje duke treguar se sa mirë mund ta kalërojë atë.

“Ahmadi i giorë i hutuar nuk e di se në çfarë është futur. Atij i japin një shpatë – një shpatë të madhe vikinge – dhe ai nuk është në gjendje ta mbajë. Shakaja është se atij i thuhet të rritet më i fortë. Dhe çfarë bën Ahmad? E gjen një mjeshtrë metal dhe e shndërron atë në një shpatë të bukur arabe që ka më shumë mundësi prerëse se shkopi që i dhanë”, thotë Lewis. “A e dini se ‘ritu më i fortë’ u bë slogan në mesin e një njesie të veçantë në ushtrinë e Shteteve të Bashkuara? Ishte edhe në banderola. Ai moment



bëri jehonë te shumë njerëz”.

Një tjetër moment që bie në sy është kur udhëheqësi viking e pyet Ahmadin nëse mund të “vizatojë tingujt” (d.m.th. të shkruajë), duke e vënë dijetarin arab përballë analfabetëve veriorë. Për të treguar se mundet, Ahmadi zgjedh të shkruajë, në arabisht, deklaratën e besimit mysliman: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është Dërguari i Tij”. Është mirë ta shohësh këtë në film në një mënyrë që thjesht është edukative dhe pa asnjë ngjyrim të keq. “Mund të kishte shkruar emrat e burrave ose diçka tjetër, por zgjodhi të shkruajë atë mban në zemër”.

“Ndoshta ishte çorientuese – por në një mënyrë të mirë – për audiencën perëndimore që të shohin shkrimin dhe mësimin që ka të bëjë me veprat arabe dhe Islamin”, thotë Dr. Lynn Shutter, profesore e anglishtes në Universitetin Shtetëror të Kolorados.

Duke qenë se Ahmadi është një mysliman praktikues, filmi shmang një aspekt tjetër që Holivudi shpesh përdor edhe kur synon përfaqësimin pozitiv – ai është një person simpatik jo për shkak të distancës që krijon besimi i tij, por pikërisht për shkak të tij.

Kjo nuk do të thotë se Ahmadi është portretizuar vetëm në aspektin pozitiv. Fillimisht, ai largohet nga Bagdadi si ndëshkim për një aferë me një grua të martuar – një shkelje e rëndë për një mysliman të devotshëm. Në fillim, ai është gjykues, arrogant dhe paksa i dhënë pas modës, siç e thotë Lewis.

“E keni një njeri nga një qytetërim i përparuar, i cili, për mëkatet e bëra, është dëbuar te njerëzit që janë të përfshirë në një konflikt të tmerrshëm dhe ai nuk është i përgatitur për të luftuar”, thotë Lewis. “Por, edhe si i huaj dhe si dikush që nuk ishte personi më i respektuar në vendlindjen e tij, ai shihej

gjithmonë si njeriu më i qytetëruar në atë mes”.

“Ishte interesante të kishim një personazh me këndvështrimin e një myslimani arab, i cili fillimisht vëzhgonte vikingët dhe shihte se sa barbarë dhe të pahijshëm ishin në sjelljen e tyre, veçanërisht në pjesën e hershme të filmit”, thotë Shutter.

Kjo dinamikë nuk ishte thjesht një largim i madh nga përshkrimet standarde të Holivudit për iluminizmin dhe epërsinë perëndimore; ishte pothuajse një përmbysje e plotë e qasjeve të tilla. Këtu ishte një personazh arab i ndarë nga kultura e vet, duke hyrë në një botë alternative perëndimore dhe më pas duke u kthyer në “shoqërinë e civilizuar” si një njeri më i mirë.

Është inkurajuese të shihet shoqëria dhe respekti i ndërsjellë që zhvillohet mes Ahmadit dhe vikingëve. Sipas Lewisit, Luftëtari i 13-të madje u shfaq në një klasë në akademinë ushtarake të Ushtrisë Amerikane në Uest-Point.

“Një nga gjërat për të cilat jam krenar për këtë film është se vikingët nuk e vënë kurrë në dyshim besimin e tij”, thotë Lewis. “Ata janë sarkastikë dhe cinikë, por gjithmonë janë aty me të”.

Natyra gjithëpërfshirëse e personazheve të vikingëve e bën më të vështirë që filmi të përshtatet me narrativat e supremacistëve të bardhë, një shqetësim që Shutter e përmend si problematikë në portretizimet letrare të Mesjetës. Pavarësisht se vikingët janë multiracialë dhe multikulturorë, e djathta ekstreme e përdor si armë zbardhjen e pasaktë të historisë së tyre.

Megjithëse filmi shmang disa metafora të dëmshme, ai ka të meta, ndoshta për shkak të zhanrit aksion-aventure në të cilin zhvillohet.

“Një nga problemet që kam me filmin është se promovon një model të dhunës mashkullore”,

thotë Shutter. “Edhe kur e prezanton Ahmadin pozitivisht, si një njeri të ditur, ekziston sugjerimi se ai nuk është burrë ‘i vërtetë’ në fillim dhe se bëhet burrë ‘i vërtetë’ duke hyrë në kulturën e luftëtarëve të vikingëve. Fantazia prapa këtij versioni të maskulinitetit – që është e nevojshme të jesh luftëtar sepse ka njerëz të këqij që bëjnë gjëra të këqija dhe ti duhet të jesh ushtarakisht i fortë për t’i mposhtur ata – mund të jetë mjaft e rrezikshme”.

Ekzistojnë gjithashtu disa çështje rreth autenticitetit që ndoshta ishin anashkaluar në atë kohë, kjo për shkak të mungesës së përfaqësimit pozitiv mysliman në ekran.

“Nuk mund t’i mohoj ndjenjat e mia personale për filmin – që më pëlqeu shumë – me realitetin se si është të punosh sot në Holivud”, thotë Aslan, “sepse ajo për të cilën mendoja 25 vjet më parë është se Luftëtari i 13-të nuk mund të shmanget nga fakti se një spanjoll luan një arab; se ishte shkruar, drejtuar dhe prodhuar nga joarabë dhe jomuslimanë. Procesi i bërjes së tij dhe produkti përfundimtar – sado interesant që ishte filmi – ishte krejtësisht i lirë nga autenticiteti”.

Luftëtari i 13-të nuk është aspak një film i përsosur. Por, edhe një çerek shekulli më vonë, mbetet i këndshëm për t’u parë, me një histori tërheqëse, skena dhe kostume të mira, dhe sekuenca interesante të aksionit.

“Isha vërtet krenar për punën time në Luftëtarin e 13-të”, thotë Lewis. “Nuk është puna ime t’i drejtoj kritikët, por thjesht nuk mund të paramendoj se çfarë prisnin. Nuk ishte fantashkencë, megjithatë ishte. Nuk ishte uestern, por megjithatë ishte. Nuk ishte film horror, por prapëseprapë ishte, kështu që ndoshta ata mendonin se ishte – siç thonë në Holivud – një peshk me pupla”. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ademi dhe Berisha diskutojnë për ndërtimin e shkollës së mesme të futbollit



“Epoka e re”

PRISHTINË, 27 GUSHT - Një delegacion i Federatës së Futbollit të Kosovës i kryesuar nga presidenti Agim Ademi e ka vizituar Komunën e Fushë Kosovës. Gjatë kësaj vizite, presidenti Ademi me bashkëpunëtorë u takuan me kryetarin e kësaj komune, Burim Berisha, për të diskutuar rreth riorganizimit të KF Fushë Kosova, avancimin e infrastrukturës së futbollit në këtë komunë dhe projektet e ardhshme të futbollit. Kryetari Berisha shprehu një interes të thellë për formatin e ri të organizimit të klubit, duke u fokusuar në rritjen e cilësisë së infrastrukturës organizative dhe teknike. Ai theksoi rëndësinë e zhvillimit të shkollës së futbollit të këtij klubi, duke pasur parasysh numrin e madh të nxënësve në komunën e Fushë Kosovës, që aktualisht janë rreth 11,000. Synimi është të krijohen kushte optimale për nxënësit e talentuar dhe të

mundësohet një organizim dhe menaxhim më i mirë i klubit dhe i shkollës së futbollit. Një projekt kyç që u diskutua gjatë këtij takimi është edhe ndërtimi i shkollës së mesme të futbollit në regjionin e Fushë Kosovës, projekt ky i presidentit Ademi. Komuna ka ndarë një sipërfaqe toke për këtë projekt, i cili do të ofrojë mundësi për 300 deri në 500 nxënës, duke përfshirë konvikte dhe infrastrukturë moderne, në përputhje me standardet më të avancuara evropiane. Kjo shkollë do të shërbejë si një qendër për zhvillimin e talenteve në futboll dhe do të ofrojë mundësi për nxënësit që të ndjekin karrierën e futbollit dhe të angazhohen në të gjitha formatet e tij. Pjesë e ndërtimit të këtij projekti do të jetë gjithashtu shoqata “Jetimat e Ballkanit”. Komuna e Fushë Kosovës do të kontribuojë me parcelën e tokës, do të ofrojë lejet e nevojshme dhe do të trajtojë çështjet administrative të rëndësishme për realizimin e këtij projekti. Po ashtu, për realizimin e këtij projekti FFK do

të mbështetet edhe tek sponsorët e vet, të cilët përfshihen në vazhdimësi në projekte të tilla si dhe në ndihmën e UEFA-s dhe FIFA-s. “FFK-ja shpreson që ky projekt do ta marrë edhe mbështetjen nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Sportit, pasi do të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin e futbollit në Kosovë dhe do të ofrojë mundësi të reja për nxënësit, e po ashtu do të shërbejë si çdo shkollë tjetër, e ku nxënësit që nuk e gjejnë veten në futboll do të kenë mundësi të vazhdojnë studimet edhe në profile të ndryshme akademike, në përputhje me standardet e arsimit të Republikës së Kosovës”, thuhet në njoftimin e FFK-së. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i diskutimeve me kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës ishte edhe fillimi së shpejti i ndërtimit të tribunave të stadiumit të këtij qyteti, i cili do të kategorizohet si stadium i kategorisë së dytë të UEFA-s, e ku do të mundësohet edhe zhvillimi i ndeshjeve të garave evropiane të klubeve.

SHKURT

FC Suhareka përforcohet me Betim Halimin

Klubi i Superligës në futboll, FC Suhareka ka njoftuar se transferim ë i ri i skuadrës është Betim Halimi. Halimi ka një përvojë të madhe ku ishte pjesë e disa skuadrave vendor, por edhe për një kohë luajti edhe në Shqipëri, Ukrainë dhe Estoni. “Halimi me shumë përvojë përforcon portën tonë së fundmi pjesë e SC Gjilani e në të kaluarën ka mbrojtur portat e shumë skuadrave si vendore e jashtë vendit si FC Drita, KF Hajvalia, JK Trans Narva, Olimpik Donetsk, FC Prishtina, FK Kukësi”, thuhet ndër të tjera në njoftimin e Suharekës.

Tristan Ikpe përforcon KB Peja

KB Peja po vazhdon përforcimin e skuadrës për edicionin e ri 2024/25. Së fundmi, klubi pejan ka njoftuar se ekipi është pasuruar edhe me një basketbollist amerikan. Bëhet fjalë për Tristan Ikpe, 210 centimetra i gjatë, i lindur në vitin 1999. Ish-kampionët ka kohë që kanë nisur konsolidimin, duke filluar me konfirmimin e Rami Hadar në krye të shtabit teknik. Deri tani, pejanët kanë njoftuar vazhdimin e kontratës me Musab Malën e Andi Mehmetin, kurse kanë rikthyer në skuadër njërin prej aseteve më të mëdha të basketbollit kosovar, Arti Hajdarin. Poashtu nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Pejë ka zbarkuar Rron Ukaj, derisa janë bërë me dije edhe disa transfere të tjera, si Adong Makoui, pastaj Jawaun Daniels, Shahada Wells e Jacques Yow. Nga vendorët, armë shtesë të pejanëve do të jenë: Rron Dahsyla, Shëndrit Llapit e Amin Hot.

Trajneri i Ipswichit beson në transferimin e Brojës

E ardhmja e sulmuesit shqiptar të Chelseat, Armando Broja ende është në dilemë. Afati kalimtar i kësaj verë mbyllet të premten. Reprerentuesi i Shqipërisë është i lidhur me transferimin tek Ipswich Town. Trajneri i kësaj skuadre, Kieran McKenna konfirmoi se klubi është ende në bisedime me Chelsean për një marrëveshje të mundshme për sulmuesin Armando Broja. “Armando Broja, sigurisht që është një lojtar me të cilin kemi folur”, ka thënë McKenna. “Ka diskutime me Chelsean për momentin, por unë nuk kam qenë në dijeni të tyre në 24 orët e fundit. Ka diskutime në vazhdim, kështu që ne do të shohim nëse është gjëja e duhur për klubet dhe lojtarin para të premtës”, ka theksuar McKenna.

Nga 7 deri më 11 shtator zhvillohen çerekfinalet e Superkupës në basketboll

PRISHTINË, 27 GUSHT - Nga 7 deri më 11 shtator në Prizren do të zhvillohet Superkupa e Kosovës në basketboll. Tetë skuadrat e elitës pritet të sjellin spektakël të basketbollit. Pas përfundimit

të 28 xhirove të edicionit të kaluar, tashmë dihen çiftet çerekfinale. Fituesja e fundit, Trepça do të ndeshet me Borën, derisa finalistja Peja do të përballlet me Proton Cable Prizrenin. Sfidë

interesante do të jetë mes Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit, si dhe mes Sigal Prishtinës e Vëllaznimit. Në ditët në vazhdim do të jepen detaje për Superkupën e Kosovës që zhvillohet në

palestrën “Sezai Surroi” të Prizrenit. Ndheshjet çerekfinale: Trepça-Bora, Peja-Proton Cable Prizreni, Golden Eagle Ylli-Bashkimi, Sigal Prishtina-Vëllaznimi.



Vinicius: Duam ta fitojmë 'Tripletën'

MADRID, 27 GUSHT - Vinicius Junior është i uritur për të fituar trofe të tjerë. Sulmuesi brazilian e inspiroi Real Madridin drejt suksesit në La Liga dhe në Ligën e Kampionëve në edicionin e kaluar, ndërsa së fundmi e fitoi edhe Superkupën e Evropës. Kandidati kryesor për ta fituar "Topin e Artë" nuk e ka

fshehur dëshirën dhe objektivin për ta fituar "Tripletën" në këtë sezon. "Çdo vit objekti yni është të fitojmë sa më shumë tituj të jetë e mundur. Copa del Rey gjithmonë na largon nga 'Tripleta' sepse luhet kundër skuadrave të vështira gjatë gjithë janarit, e cila është periudha kur ka më së shumti

ndeshje për t'u luajtur. Kompeticioni i Kupës përfundon për t'i komplikuar paksa gjërat, por është motivuese për ta fituar më në fund një 'treshë' të trofeve", ka deklaruar ylli brazilian në një intervistë të gjatë të dhënë në "CNN". "Natyrsh, prioritet është Liga e Kampionëve, që është kompeticioni më i

vështirë, më pas vjen kampionati dhe më tutje Kupa. Secili e ndien presionin për shkak të peshës së Championsit dhe për shkak se Real Madridi e do gjithmonë këtë trofe", ka shtuar Vinicius Junior. "Dhe, jo vetëm lojtarët, por edhe tifozët janë ata që e kërkojnë, pra për ta fituar këtë kompeticion. Objektiv yni



është të mundahe mi t'i fitojmë të gjitha dhe më në fund t'ia dalim ta fitojmë 'Tripletën', nënvizoi tutje braziliani.

Guardiola: Haaland, një 'kafshë' e pazëvendësueshme

MANCHESTER, 27 GUSHT - Pep Guardiola thotë se Erling Haaland është "i pazëvendësueshëm" për Manchester Cityn. Fjalët e trajnerit vijnë pasi sulmuesi norvegjez realizoi tregolëshin e tij të 10-të për klubin në fitoren 4-1 të së shtunës ndaj Ipswich, ndërsa starti 100% perfekt i sezonit për "qytetarët" vazhdoi. Tripleta e 24-vjeçarit pasoi golin e tij në fitoren 2-0 në javën e parë ndaj Chelsea në "Stamford Bridge", që do të thotë se ai kryeson tabelën e golshënuesve të kampionatit me katër gola. Nisja e tij e fortë e sezonit vjen pasi ai kreu të plotë fazën përgatitore të skuadrës, ku shënoi pesë gola në katër ndeshjet miqësore të luajtura në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dhe Guardiola beson se atributet e Haalandit janë të çmuara për "qytetarët", por thotë se minutat e norvegjezëve mund të kenë nevojë të menaxhohen kur programi i ndeshjeve të intensifikohet, veçanërisht në mungesë të Oskar Bobit, i cili do të mungojë për tre deri në katër muaj pas një thyerje në kockën e këmbës. "Sezonin e



kaluar Haaland ishtë i mirë", ka thënë Guardiola. "Është mirë kur luan një herë në javë, por do të duhet të shohim se çfarë do të ndodhë kur të nisim kalendarin e çmendur për të gjitha skuadrat pas pushimit ndërkombëtar, kur fillojmë Ligën e Kampionëve, Kupën Karabao dhe Premier Ligën. Kemi edhe mungesën e Oskarit, i cili mund të luante edhe në atë pozicion, sepse është vërtet i mirë, por sigurisht që Erling është i pazëvendësueshëm për shumë aspekte. Ne do të gjejmë një mënyrë kur ai të ketë nevojë për pushim ose rrethana të tjera, shpresojmë që jo. Por shpresojmë që ai të vazhdojë të jetë klinik dhe të luajë mirë". Pasi Ipswichi kaloi në avantazh, City barazoi me

penalltinë e Haalandit kur Savinjo u pengua brenda zonës. Më pas kampionët kaluan në avantazh kur norvegjezi dhe braziliani përmbysën në mënyrë të pamëshirshme "Tractor Boys", ndërsa Kevin de Bruyne shënoi edhe një tjetër gol. Dhe Guardiola thotë se 24-vjeçari që udhëheq sulmin e "Qytetarëve" është vendimtar për planin e tij të lojës së Cityt. "Më pëlqen kur vrapon shumë. Më pëlqen kur bën presion si kafshë, më pëlqen. Kjo ndihmon që të shënosh një gol. Kur je i lidhur në mbrojtje, je i lidhur në sulm. Kur je i shkëputur nga mbrojtja, topi të vjen dhe të befason, nuk je i saktë. Ata e dinë se çfarë duhet të bëjnë dhe na ndihmojnë me gjuhën e trupit të tij. Nëse qendërmbrojtësi ka topin, bëje atë të vrapojë me këtë trup, me ato këmbë në lëvizje, është e frikshme dhe i ndihmon njerëzit në mes ta mbështesin dhe ne jemi më efektivë në presingun tonë të lartë. Ne kemi nevojë për të, kjo nuk është e negociueshme. Nëse ai nuk shënon një gol është mirë, por ju duhet ta bëni atë", ka deklaruar Guardiola.

Talenti italian teston Mercedesin në garën e Monzas, pritet të zërë vendin e Hamiltonit sezonin e ri

Londër, 27 gusht - Duket se Mercedesi do të zgjidhë këtë fundjavë enigmën se cili do të jetë piloti që do të zëvendësojë Lewis Hamilton sezonin e ri. Në pistën e Monza, ku të dielën do të zhvillohet gara e radhës në Formula 1, do të hipë në makinën gjermane piloti i ri italian Kimi Antonelli. Talenti që garon në Formula 2 me Prema, dy ditë më parë festoi 18-vjetorin e tij dhe këtë të premte do të testojë në provat e lira makinën Mercedesit të George Russell. "Marrja për herë të parë pjesë në provat e lira të një gare të



Formula 1 do të jetë diçka vërtet e veçantë. Jam shumë i lumtur që drejtoj W15 dhe që do të ndaj pistën me të gjithë ata shoferë të jashtëzakonshëm. Mezi po pres!", ka thënë Kimi Antonelli. Antonelli aktualisht është në vendin e shtatë

në kampionatin e Formula 2, me një sukses të arritur në Silverstone. "Të bëj debutimin tim në Formula 1 para tifozëve të mi është një çmenduri. Mezi pres të mësoj shumë, por edhe të kontribuoj për të ndihmuar ekipin për fundjavën", ka thënë italiani. Antonelli e ka testuar tashmë W13, makinën e vitit 2022, në Imola, por ky do të jetë testi i tij i parë në një fundjavë garash. Ai mund të ketë një shans tjetër këtë sezon, këtë herë duke ngarë makinën e Hamilton në provat e lira ose në Meksikë ose në Abu Dhabi.

SHKURT

Conceicao, lojtar i ri i Juventusit

Juventusit ka konfirmuar zyrtarisht transferimin e sulmuesit anësor, Francisco Conceicao nga Porto. "Zonja e Vjetër" ka vazhduar me përforsime në këtë verë, pasi dëshiron të jetë sa më konkurrues në Serie A dhe Ligën e Kampionëve. Pasi ka kompletuar transferimet e Michele Di Gregorio, Douglas Luiz, Khephren Thuram, Juan Cabal, Pierre Kalulu dhe Nico Gonzalez, Juventusit ka njoftuar një tjetër përforsim. Bëhet fjalë për sulmuesin anësor portugez, Conceicao, i cili tashmë është zyrtarizuar si lojtar i ri i Juventusit. "Një tjetër shtesë e re e familjes Bianconeri është tashmë zyrtare: ajo e Francisco Conceicao, i cili arrin në Torino si huazim për këtë sezon", thuhet në njoftim. Juventusit ka njoftuar se huazimi deri më 30 qershor 2024 se do t'i kushtojë shtatë milionë euro plus tre milionë euro tjera bonuse.

Al Hilali arrin marrëveshjen me Cityn për Cancelon

Gjigantët e Arabisë Saudite, Al-Hilal, thuhet se kanë arritur një marrëveshje me Manchester Cityn për nënshkrimin e Joao Cancelo. Siç raportohet nga eksperti i merkatos Fabrizio Romano, kampionët e Ligës Pro Saudite kanë rënë dakord për një marrëveshje rreth 25 milionë euro për portugezin. Romano ka zbuluar gjithashtu se portugezët i është ofruar një marrëveshje me vlerë 15 milionë euro neto në sezon. Megjithatë, 30-vjeçari ende nuk ka vendosur për të ardhmen e tij. E ardhmja e Cancelos të Manchester City ka qenë e pasigurt për një kohë të gjatë që kur ai pati një përplasje me Pep Guardiolen pas Kupës së Botës 2022. Ai është larguar nga "Etihad" që nga janari 2023, duke kaluar gjysmën e dytë të sezonit 2022-2023 te Bayern Munich dhe sezonin e fundit te Barcelona në huazim.

Bravo pensionohet nga futbolli

Ish-portieri i Barcelonës, Claudio Bravo, është pensionuar nga futbolli. Kiliiani hoqi dorëzat pas një karriere 22-vjeçare në futbollin e seniorëve. E nisi me Colo-Colon për katër vjet, pastaj gëzoi tetë vjet të bukura te Real Sociedad, për të kaluar më pas te Barcelona për dy vjet ku edhe e fitoi Ligën e Kampionëve. Për katër vjet qëndroi te Manchester City, e po atë vite edhe te Real Betisi ku edhe i dha fund karrierës. Mes titujve të fituar, ai e ka edhe La Ligën dy herë, Kupën e Mbretit dy herë, Superkupën e UEFA-së një herë, Kupën e Botës për Klube një herë, Premier Ligën njëherë, Copa American me Kilin dy herë.

Skriniar largohet nga PSG-ja, shkon tek Al Nassri

Pasi përfundoi në periferi të projektit të Luis Enrique te PSG-ja, Milan Skriniar tashmë ka bërë gati valixhet. Ish-lojtari i Interit është shumë pranë kalimit në Arabinë Saudite, konkretisht tek Al Nassr, klubi ku luajnë Brozović, Cristiano Ronaldo dhe Mane ndër të tjerë. Fabrizio Romano e zbulon këtë. Marrëveshja duhet të realizohet në baza të përhershme: dy klube italiane kishin eksploruar gjithashtu mbrojtësin sillovak.

Ronaldo: Ja ku do ta mbyll karrierën

Mosha për një lojtar si Cristiano Ronaldo është thjesht një numër, kështu pritet të jetë edhe për disa vite, pasi portugezi as që ka ndërmend të "var këpucët në gozhdë". Për të gjitha ata që

mendojnë të kundërtën, mbi të gjitha kur bëhet fjalë për përfaqësuesen portugeze, Ronaldo ka një përgjigje: "Nuk e di se kur do të tërhiqem nga futbolli, e sigurt është se jo tani,

mbase pas 2-3 vitesh, por jo tani. Me shumë mundësi do ta mbyll tek Al Nassri. Jam shumë i lumtur këtu, ndihem mirë në këtë vend, më pëlqen të luajë në Arabinë Saudite". "Jam gjithnjë krenar që

përfaqësojë vendin tim, ngjyrat tona, ëndrrat tona. Për këtë motiv kur të vendos se do të largohem nga përfaqësuesja nuk do t'ia them askujt më herët, kjo pasi mendoj se do të jetë një vendim

spontan", ka shtuar Ronaldo. Sipas të gjithë gjasave, nëse gjërat shkojnë sipas parashikimeve, Ronaldo të jetë pjesë e Portugalisë edhe në Botërorin e 2026.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Sunnex Energy" L.L.C, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore 3 MW në lokalitetin "Dubravë", ZK. Lladroc, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.10.2024 në ora 10:00 në Shtëpinë e Kulturës "Tahir Sinani" në Malishevë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Sunnex Energy" L.L.C, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për parkun e energjisë diellore 3 MW në lokalitetin "Dubravë", ZK. Lladroc, Malishevë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/83289158888?pwd=2iNvxgGDBZhlasbnib7psikUDn3job.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Sunnex Energy" L.L.C, Prishtinë, për parkun e energjisë diellore 3 MW në lokalitetin "Dubravë", ZK. Lladroc, Malishevë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Solaxy" L.L.C, Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore 9 MW në lokalitetin "Dubravë", ZK. Lladroc, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.10.2024 në ora 11:00 në Shtëpinë e Kulturës "Tahir Sinani" në Malishevë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Solaxy" L.L.C, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për parkun e energjisë diellore 9 MW në lokalitetin "Dubravë", ZK. Lladroc, Malishevë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us06web.zoom.us/j/85843285174?pwd=pLc4aVgTLUvohJxbftSulQ4yLSc08.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Solaxy" L.L.C, Prishtinë, për parkun e energjisë diellore 9 MW në lokalitetin "Dubravë", ZK. Lladroc, Malishevë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dashnor Metaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Erblina Duraku shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Halim Hoti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Bajram Curi " Krushe e Madhe.
- Florent Aliu shpall të humbur dëftesën e kl. së dymbëdhjetë të shkollës së mesme Medreseja "Alaudin" Prishtinë.
- Danjella Keqani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, X të shkollës së mesme "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjenet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjenet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 9.2 dhe 15 të Ligjit 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, nenit 6 të Rregullores (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në ZKA; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 dhe Vendimit Nr. 1322 të datës 26.08.2024, Zyra Kombëtare e Auditimit, shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të punës

Pozita: Ndhmës Auditor i Përgjithshëm
Numri i referencës: NAP/ZKA/08-07/24
Klasa/Koef/Grada: A10 – 13.2 - ZKA-A2
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me mandat Pesë (5) vjet

Qëllimi i Pozitës:

Ndhmës Auditori i Përgjithshëm është përgjegjës për funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve në fushën audituese, në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit (PVA), të miratuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ndhmës Auditori i Përgjithshëm, është përgjegjës për dizajnimin dhe zhvillimin e objektivave të auditimit, si dhe bën përgatitjen e planeve të punës sipas PVA-së;
- Menaxhon dhe administron punën e përgjithshme të fushës së përcaktuar të auditimit dhe siguron zbatimin e funksioneve të tij;
- Siguron zbatimin e PVA-së me qëllim të përmbushjes së mandatit dhe funksionit të ZKA-së;
- Menaxhon me personelin nën vartësi të tij, si dhe në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve të auditimit, analizon dhe vlerëson proceset e ZKA-së, si dhe në pajtim me Auditorin e Përgjithshëm, vendos për ndryshimet/përmirësimet me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
- Me autorizim të Auditorit të Përgjithshëm, përfaqëson ZKA-në, në fushat dhe çështjet që ndërlidhen me mandatin dhe funksionin e tij;
- Ofron udhëzime dhe këshilla të sakta dhe të paanshme profesionale për Auditorin e Përgjithshëm, në fushën përkatëse;
- Bën vlerësimin e rregullt e nëpunësve nën mbikëqyrjen e tij, si dhe mbështet zhvillimin profesional të tyre përmes kryerjes së skemave profesionale të auditimit, me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre në përputhje me standardet profesionale të punës;
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplome fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike ose administratës publike;
- Pesë (5) vite përvojë menaxheriale;
- Të jetë i certifikuar për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).

Shkathësitë e kërkuara:

- Shkathësi të nivelit të lartë në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese, dhe komunikuese në menaxhim të performancës.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik);
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Informatat rreth këtij procesi do publikohen në faqen zyrtare të internetit të ZKA-së. Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **12.09.2024 ora 16:00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen/shkarkohen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00. Formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 9.2 i 15 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, kao i članova 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije, člana 6 Uredbe (NKR) Br. 02/2021 o Klasifikaciji radnih Mesta u NKR; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2024. godinu i Odluke Br. 1322 od datuma 26.08.2024.godine, Nacionalna Kancelarija Revizije, objavljuje:

KONKURS za dopunu radnog mesta

Pozicija: Pomoćnik Generalnog Revizora
Broj reference: NAP/ZKA/08-07/24
Klasa/Koef/Rang: A10 – 13.2 - ZKA-A2
Broj pozicija: Jedna (1)
Trajanje imenovanja: Sa mandatom Pet (5) godina

Svrha pozicije:

Pomoćnik Generalnog Revizora je odgovoran za rad i koordinaciju aktivnosti u oblasti revizije, u skladu sa Godišnjim planom revizije (GPR) odobren od strane Generalnog revizora.

Dužnosti i Odgovornosti:

- Pomoćnik Generalnog Revizora, odgovoran je za dizajniranje i razvoj ciljeva revizije, kao i za pripremu planova rada prema GPR-u;
- Upravlja i administrira ukupnim radom određene oblasti revizije i obezbeđuje sprovođenje njenih funkcija;
- Osigurava efikasno sprovođenje GPR-a u cilju ispunjavanja mandata i funkcije NKR-a;
- Upravlja svojim podređenim osobljem, i u saradnji sa direktorima departmana revizije, analizira i procenjuje procese NKR-a, i u skladu sa Generalnim revizorom odlučuje o izmenama/poboljšanjima u cilju povećanja efikasnosti u radu;
- Po ovlašćenju glavnog revizora, predstavlja NKR, u oblastima i pitanjima koja se odnose na njen mandat i funkciju;
- Pružta tačne i nepristrasne profesionalne smernice i savete generalnom revizoru, u relevantnoj oblasti;
- Vrši redovnu procenu zaposlenih pod njegovim nadzorom, kao i podržava njihov profesionalni razvoj kroz izvođenje šema profesionalne revizije, kako bi obavljali njihov zadatak u skladu sa standardima profesionalnog rada;
- Na zahtev Generalnog revizora, obavlja i druge poslove u vezi sa objektivima NKR-a.

Tražene kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Sedam (7) godina iskustva u oblasti računovodstva, revizije, javnih finansija, ili javne uprave;
- Pet (5) godine rukovodećeg iskustva;
- Da bude sertifikovan za eksternu reviziju (sertifikovani revizor ili sertifikovani revizor javnog sektora).

Potrebne veštine:

- Visok nivo veština u upravljanju, organiziranju i postavljanju objektivna;
- Odlično znanje za efektivan nadzor nad profesionalnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Veštine rukovođenja, motivacije i komunikacije u upravljanju učinkom;

Opšte informacije za kandidate:

Nadoknada plate za objavlenu poziciju se vrši u skladu sa zakonodavstvom na snazi.

Procedura Prijave:

Procedura prijave je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa.

Kandidati treba da dostave sledeće potrebne dokumentacije:

- službeni Formular NKR-a za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi (Fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti overene kod notara;
- Sertifikat za eksternu reviziju (sertifikovani revizor ili sertifikovani revizor javnog sektora).
- dokazi o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz penzijskog Fonda);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog funkcionera (ako je primenljiva);;

Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu. Samo službeni formular za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Informacije o ovom procesu biće objavljene na zvaničnom internet sajtu NKR-a. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na sajtu Nacionalne Kancelarije Revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **12.09.2024 do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Diviziji za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenu izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u razmatranju.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

